

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.99 /2025	Data: 30.05.2025	

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika c) nenit 68 paragrafi 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/2008) dhe në pajtim me nenin 34 paragrafi 34.2 të Statutit të Komunës, 01Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2025 shqyrtoi dhe shpalli në diskutim publik Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit, Pejë, Klinë,Istog, Deçan dhe Junik 2025-2035,dhe mori këtë:

V E N D I M SHPLLJE NË DISKUTIM PUBLIK

1. MIRATOHET Vendimi për shpallje në diskutim publik të Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit, Pejë, Klinë,Istog, Deçan dhe Junik 2025-2035.
2. Diskutimi publik për Planin e cekur më lartë, do të jetë i hapur prej 30.05.2025 deri më 13.06.2025.
3. Inkurajohen dhe ftohen të gjithë qytetarët, personat juridik dhe shoqatat civile në territorin e Komunës së Istogut, që t'i parashtojnë vërejtjet dhe propozimet e tyre në këtë Plan brenda kohës dhe afatit të përcaktuar në pikën 2. të këtij Vendimi.
4. Për çdo informatë të interesuarit mund të drejtohen në Zyrën për Informim, zyrtarit përgjegjës për Dëgjime Publike, në objektin e Komunës së Istogut.
5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij në Kuvendin e Komunës së Istogut. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Zyrtari përgjegjës për Dëgjime Publike dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
6. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetari i komunës dhe një kopje në arkivin e Kuvendit të Komunës së Istogut.

00

 REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E ISTOGUT / OPŠTINA ISTOK DIREKTORATI PËR ADMINISTRIMIN / DIREKCIJA UPRAVE		
Nr./Br. 039 - 72	Nr. i faq/Br. str. 01	
Data-Datum 04.06.2025		

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

E Rugova

